



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.11.2021

**MBLEDHJA Nr. 51,**  
**datë 09.11.2021, ora 10:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 09.11.2021, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 51 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Tetor 2021
2. Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021
3. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018 mbi licencimin e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., (FTL sh.a.) në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike
4. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018, mbi transferimin e licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e bordit të komisionerve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, tek shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. (O.S.SH sh.a. ), e vlefshme deri me datë 27.10.2044
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e asetëve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (United Bank of Albania) sh.a.
6. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALBESP Trading & Consulting” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
7. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ALBESP Trading & Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike

## 8. Çështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**Në mungesë dhe me autorizim**  
**Komisioneri Adriatik BEGO**